



Tiranë, E Diel, dt. 28.10.2018, Ora 12:00

Shoqata “ALEANCA QYTETARE PËR MBROJTJEN E VLERAVE KOMBËTARE”,

Shoqata: “ILIRICUM SACRUM’

Shoqata “IMAZHI SHQIPTAR”

Shoqata “VLERAT SHQIPTARE”

QENDRA KËRKIMORE SHKENCORE – G & G GROUP

Organizojnë:

KUVENDIN MBARËKOMBËTAR

“VAZHDIMËSIA HISTORIKO-GJUHËSORE DHE ETNOKULTURORE E SHQIPTARËVE”

Tiranë, 02-04 Mars, 2019, Muzeu Kombëtar

PROCES VERBAL I MBLEDHJES SË PARË

MBLEDHJE E PARË E GRUPIT ORGANIZATOR PËR MBAJTJEN E KËTIJ KUVENDI

Pasi kemi reflektuar nga sugjerimet e ardhura, sot ndodhemi në gatitje për fillimin e një nisme që me plot gojë, së bashku mund të themi na qoftë udha e mbarë. Një grup Shoqatash në Tiranë dhe një grup jo i vogël individësh, kanë menduar të organizojnë një Kongres Ndërkombëtar (Kuvend Mbarëkombëtar), mbi vlerat e shqipes dhe shqiptarëve në mijëvjeçarë. Mbas shumë diskutimesh kemi arritur të përpilojmë një draft, me qëllimin dhe objektivat përkatëse, si dhe hapat që duhet të ndjekim të shoqëruara me vendimet përkatëse.

Pjesëmarrësit në vendimin për kongresin:

Sazan Guri, Stefan Pinguli, Eva Brinja, Lirim Muhaj, Fredi Balaj, Asqeri Boçi, Kujtim Mateli, Përparim Zaimi, Linda Spahiu, Sulejman Mato, Osman Metalla, Maksim Zarka.

Minutat e takimit dhe përfundimet

Prezantimi i shkurtër i grupit organizator

Sazan Guri zotëron një studio si qendër kërkimore shkencore për çështje të gjeoshkencës, mjedisit dhe historiko-gjuhësore. Krahas studimeve, kjo studio është e aftë të organizojë kuvende dhe simpoziume shkencore për këto fusha. Praktikisht, edhe për rastin konkret “Zgjidhja gjenetike”, duke



marrë pjesë në organizimin e Kuvendin Mbarëkombëtar, “Vazhdimësia historike dhe gjuhësore, thrako-iliro e pellazgo-epire në dritën e diturive të sotme”.

Stefan Pinguli inxhinier dhe sipërmarrës. “Kam bindjen se jemi të veçantë për të zgjidhur këto probleme. Kemi fondacion që të mbledhim informacione. Shqipëria nuk ka dokumente, sepse është marrë me politizime. Unë e them hapur se kam patriotizëm ekonomik, sepse jam marrë me tregti. Mendoj se duhet të ndërtohen institucionet dhe pastaj ne të shpërthejmë me të vërtetat tona.”

Lirim Muhaj ka botuar dy libra. Ai shkruan artikuj të ndryshëm për çështjet pellazge dhe me temë shkencore. “Kultura jonë është antikulturë. Mendoj se historia do të ndryshojë me njohjen e Pellazgjishtes. Kemi shoqatën Pellazgjishtja me 450 studiues që merren me botimet Pellazgo-Ilire. Enciklopedia greke e thotë: Pellazgët janë Shqiptarët. Pojani i Fierit është për tu zbuluar. Duhet të tërheqim skemën amerikane. Mendoj të mbahet një Kuvend Ndërkombëtar në Shqipëri.”

Eva Brinja inxhinierë mekanike, i është futur, rastësisht, duke zbuluar një element tek kostumet dhe kështu u hapën rrugët e studimit. “Zhvilimi kulturor i çdo shteti fillon tek origjina (gjeni). Trans’humanizmi, sistemi i rikuperimit të trupit po goditet nga mjekësia. Dy simbolet bazë që duhen zberthyer janë flamuri dhe përkrenarja e Skënderbeut.”

Ashqeri Boçi inxhinier mekanik në profesion. Me studimet e tij ka përfunduar se “nuk ka greqishte të vjetër, por shqipe të vjetër. Iliada është shqip, eurinët janë çamët. Troja është Iljoni. Historia është ndryshe, dhe stacioni që duhet mbështetur është Omeri Shqip.”

Mark Palnikaj ka mbaruar për inxhinieri dhe studion prej disa vitesh histori shqiptare në bibliotekën e Vatikanit gjuhë-letërsi dhe ka botuar tre libra. Nga studimet e tij rezultojnë se gjuha shqipe është gjuhë rrënjore, por nuk kemi dokumenta të ruajtura. “Në Vatikan ka 4,3km dokumente për Shqipërinë dhe nuk kemi as katër dokumente. Aty gjeta letër të Skënderbeut drejtuar Vatikanit dhe mu desh ta pagoja vet faturën pasi shteti nuk ka asnjë buxhet.”

Linda Spahiu pensioniste, ish mjeke pediatre. Ajo merret me etnografinë. Dëshira e saj filloi me kostumet tradicionale. Ka në shtëpinë e saj një muze me mbështetjen e familjarëve. “Për Amerikën është e njohur historia, sepse ata kanë shkuar te burimi, të tjerat janë naivitete të Ballkanit.”

Sulejman Mato gjuhëtar në profesion dhe ka studiuar dhe hartuar libra me historinë kishtare. Ai shprehet se ne nuk po krijojmë një brez studiuesish të vërtetë.

Përparim Zaimi është studiues i shkencave detare dhe ka botuar katër libra, ku një nga librat është për Tomorrin dhe ka shkruar për Hasan Pjetrin me fakte dhe prova. Ka vërtetuar se shkrimi pellazg është me origjinë hyjnore.



Osman Metalla ka “begrund” detar dhe është pedagog në Durrës. “Globalizmi po sjell që gjuhët të asimilohen dhe na duhet më e fortë Akademia Shkencore. Të krijohet biblioteka Pellazgo-Ilire me nga një libër të secilit në Universitetin e Durrësit dhe tek Institucioni Stela.”

Maksim Zarka ushatarak dhe historian, botues i 12 librave.

Kujtim Mateli ka studiuar për gjuhë e letërsi.

Fredi Balaj inxhinier nafte dhe ka disa vite që studion gjuhën shqipe. Ka botuar një libër me simbolika greke, që rrjedhin nga gjuha e vjetër shqipe dhe kjo shpegohet që nga simbolikat në gur.

VENDIMET QË U MORRËN:

Nga dita e hënë datë 29/10/2018 fillon zyrtarisht organizimi i “KUVENDIT MBARËKOMBËTAR MBI VAZHDIMËSINË HISTORIKO GJUHËSORE DHE ETNO KULTURORE”. Për një mbarëvajtje të suksesshme të këtij Kuvendi, ky grup mori këto vendime si fillim:

1. Do të bëhet takim zyrtar me Presidentin e Republikës z. Ilir META për ta pasur zyrtarisht kurator të këtij Kuvendi.
2. Do të bëhet takim zyrtar me një nga sponsorizuesit kryesorë, pikërisht me z. Samir MANE.
3. Do të krijohen dy biblioteka me libra mbi këtë tematikë, pikërisht në Universitetin e Durrësit Aleksandër Moisiu dhe te Institucioni Stela.
4. Do të gjendet mundësia për botimin e 500 kopjeve me ngjyra, të qarkullorit të parë mbi mbajtjen e këtij Kuvendi.
5. Do të fillojë zyrtarisht puna e organizimit të këtij Kuvendi, fillimisht, me anë të një kordinatore si antare e Sekretarisë organizative.
6. Do të vendosen marrëdhënie kontraktuale me institucionet publike si: Ministrinë e Arsimit (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni), Ministrinë e Kulturës (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni), Akademia e Shkencave Tiranë, Akademia e Shkencave Prishtinë, Universiteti i Tiranës, Universiteti i Prishtinës, Universiteti i Tetovës, Universiteti European i Tiranës, Universiteti Luarasi, Albanian University, ku më pas do të plotësohen komitetet shkencore dhe organizative me përfaqësuesit e këtyre Institucioneve.
7. U vendos njëzëri që organizimi i këtij rrjeti të shoqatave do të jete nën logon e një organizate me emërin Qendra Kombëtare “Rrënjët tona”, me Statut dhe me logon e saj individuale.

Grupi i punës

1. Propf.ing. Sazan Guri, ekspert i gjeoshkencave, mjedisit dhe avokat mjedisor
2. Dr. Stefan Pinguli, ekspert i ekonomisë,



- | | |
|------------------------------|--|
| 3. Ing. Eva Brinja, | ekspert e infrastrukturës dhe historiane |
| 4. Lirim Muhaj, | gjuhëtar dhe historian |
| 5. Prof.asc. Elena Kocaqi | gjuhëtare dhe historiane |
| 6. Ing. Anasatas Shuke | inxhinier dhe historian |
| 7. Ing. Fredi Balaj, | inxhinier dhe gjuhëtar |
| 8. Img. Asqeri Boçi, | inxhinier dhe gjuhëtar |
| 9. Kujtim Mateli, | gjuhëtar dhe historian |
| 10. Përparim Zaimi, | kapiten dhe historian |
| 11. Dr. Linda Spahiu, | mjeke dhe etnografe |
| 12. Sulejman Mato, | gjuhëtar dhe historian |
| 13. Prof.asc. Osman Metalla, | detar |
| 14. Maksim Zarka | historian |
| 15. Pal Trashaj | gjeograf dhe historian |
| 16. MSc. Arjola Bajramaj | eksperte biomjedisi |

“RRËNJËT TONA”